



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 17 tetor 2017

Numri i lëndës: 2016-07

Mentor Qela

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 17 tetor 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar
Znj. Elka ERMENKOVA, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar në Panel me datën 20 dhjetor 2016.

II. FAKTET E LËNDËS

2. Faktet e lëndës të paraqitura nga ankuesi mund të përmbliidhen si më poshtë:
3. Me 24 gusht 2011, Gjykata Supreme e Kosovës ka vërtetuar dënimin e ankuesit në dy aktakuza për "tentim vrasje të rëndë" dhe "mbajtje në

pronësi, kontroll, posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve”, përderisa është modifikuar dënimi.

4. Gjykatësit e EULEX-it janë ulur në trupin gjykues.

III. ANKESA

5. Ankesa në fjalë ka dy subjekte kryesore: procedurat gjyqësore dhe keqtrajtimin e pretenduar nga policia.
6. Sa i përket procedurave gjyqësore, ankuesi bën një numër pretendimesh për të cilat ai nuk ka ofruar informacione të pavarura të verifikueshme: gjykatësit ishin të ndikuar, kishin vendosur që nga fillimi dhe ishin të motivuar nga një përpjekje për t'i gjetur ata “pas tij”; motivi i supozuar për vrasjen (përfitimi material prej 300 eurosh) nuk bazohet në realitet pasi që ankuesi vjen nga një familje e mirë dhe nuk ka mungesë të mjeteve materiale; kjo i ishte montuar atij dhe se rasti është disi i lidhur me tenderin e IPKO-së dhe “konsorciume të fuqishme, të fuqive të mëdha”; thuhet se një dëshmitar në këtë lëndë ishte i sëmurë mentalisht; për shkak se organizatori i dyshuar i vrasjes ishte liruar, Gjykata duhet të ketë refuzuar çështjen e prokurorit në lidhje me motivin; ankuesi nuk ishte në gjendje ta mbrojë veten siç duhej dhe kishte mohuar mundësinë për t'u dëgjuar; mbrojtjes së tij pretendohet se i ishte mohuar mundësia e drejtë për të marrë pjesë dhe për të mbrojtur ankuesin.
7. Sa i përket keqtrajtimit të pretenduar të ankuesit nga ana e policisë, ai nuk specifikon datat e ndalimit të tij, por mund të nxirret nga konteksti që ai i referohet paraburgimit të tij. Ai pretendon se ishte keqtrajtuar derisa ishte në paraburgim dhe i ishte mohuar kujdesi mjekësor.
8. Ankuesi nuk i referohej ndonjë të drejtë të veçantë të njeriut se ishte shkelur. Megjithatë nga përmbajtja e ankesës duket se ankesa ka të bëjë me të drejtat e të akuzuarit siç janë të garantuara, ndër të tjera, sipas nenit 6 (gjykimi i drejtë) dhe nenit 3 (mbrojtja kundër torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës) të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (“Konventa”).

IV. LIGJI

9. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të zbatojë instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.

10. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendosë nëse do të vazhdojë me ankesat, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së punës.
11. Në pajtim me rregullin 25, paragrafi 3, të rregullores së punës, ankesat duhet të dorëzohen brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së supozuar.
12. Paneli thekson që ankesa e ankuesit ka të bëjnë me procedurat gjyqësore që përfunduan me 24 gusht 2011 me nxjerrjen e aktgjyqimit të Gjykatës Supreme dhe paraburgimi që i paraprin këtyre procedurave. Ankesa në Panel është parashtruar me 4 maj 2016. Prandaj ankesa bie jashtë afatit gjashtëmuor të parashikuar në rregullin 25 paragrafi 3 të rregullores së punës. Rrjedhimisht, ankesa nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullën 29 të rregullores së punës së Panelit.
13. Përveç kësaj, në përputhje me rregullën 25, paragrafi 1 i rregullores së punës, bazuar në konceptin e llogaridhënies të OPLAN-it të EULEX-it Kosovë, Paneli nuk ka kompetencë as në fushën administrative e as në fushën juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Fakti që gjykatësit e EULEX-it janë pjesë e trupin gjykues në ndonjë gjykatë të caktuar, nuk ia humb asaj gjykate karakterin e të qenurit pjesë e sistemit juridik të Kosovës (ndër të tjera, shih *Rifat Kadribasic kundër EULEX-it*, 2014-09, e datës 10 nëntor 2014, par. 11, *Shaban Kadriu kundër EULEX-it*, 2013-27, 27 maj 2014, par. 17).
14. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh faktin se kërkesa e ankuesit ka të bëjë me procedurat gjyqësore, Panelit i mungon juridiksioni për të shqyrtuar ankesat e tij.
15. Lidhur me pretendimet për keqtrajtim nga ana e policisë, Paneli thekson se ankesa nuk pretendon që EULEX-i ishte në ndonjë mënyrë i përfshirë ose i informuar lidhur me këtë çështje. Në këto rrethana, asnjë shkelje e pretenduar e të drejtave nuk mund t'i atribuohet Misionit.
16. Së fundi, lidhur me të dyja aspektet e ankesës, pasi që ankuesi nuk ka ofruar dëshmi për të mbështetur dhe dëshmuar pretendimet e tij, Paneli ka konstatuar se ato pretendime nuk janë mbështetur në mënyrë të duhur nga ankuesi dhe prandaj janë qartazi të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se kjo ankesë duhet të refuzohet në përputhje me rregullën 29 (c), (d) dhe (e), dhe prandaj

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese